



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

21.10.2024

Drejtuar: **BOE “SEED CONSULTING” SHPK & “DERBI-E” SHPK**

Tirane Rruga Perlat Rexhepi, Nd.8, H.1, Ap.14

Procedura e prokurimit / lotit: **Procedurë e hapur (Marrëveshje Kuadër) - Shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-14049-07-23-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve për Rajonin Qendër Lindje Korçë”, me fond limit: 46,885,610 (dyzet e gjashtë milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dhjetë) Lekë pa TVSH, Në Euro: 467,313.96 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e trembëdhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **48 muaj**

Publikimet e mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Data 29 Korrik 2024, Nr. 42**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët 50

Propozimi Teknik pikët 50

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. OE “PAT Power Automation & Teknology” SHPK L41723018R

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

Pa paraqitur

Totali i pikëve të marra: **0**

2. BOE “ARCHISPACE” & “SPHAERA” SHPK L42403012A / J81809003U

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

25,653,100.00 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

3. OE “INSTITUTI I KONSULENCES NE NDERTIM "IKN"” SHPK K71828007J

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

42,375,300.00 (dyzet e dy milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

4. BOE “SEED CONSULTING” SHPK & “DERBI-E” SHPK L41824014Q / K77916947A

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

42,700,000.00 (dyzet e dy milion e shtatëqind mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **283.50**

5. BOE “ZENIT&CO” SHPK & “GRAMA” SHPK K61731002D / J77304712J

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

43,134,960.00 (dyzet e tre milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

6. BOE “SWS Consulting Engineering-Structures, Water & Survey” SHPK & “INFRA - PLAN” SHPK

L92423018P / K62225011F

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

43,389,500.00 (dyzet e tre milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

7. OE “A & E ENGINEERING sh.p.k” K72113010E

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

43,600,150.00 (dyzet e tre milion e gjashtëqind mijë e njëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **280.50**

8. OE “C.E.C GROUP” SHPK L11807013M

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

44,297,000.00 (dyzet e katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **276.00**

9. BOE “InfraKonsult” SHPK & “Engineering Consulting Group” SHPK & “BDS Consulting Engineers” SHPK

L21512022F / M01308013C / K92417018H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

44,509,300.00 (dyzet e katër milion e pesëqind e nëntë mijë e treqind) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

10. BOE “S&L STUDIO” SHPK & “M.A.K Studio” SHPK L61606040D / L01422017O

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

44,781,000.00 (dyzet e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

11. BOE “STATENG” SHPK & “MCE” SHPK L98819501J / L72203065K

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme):

45,265,000.00 (dyzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **265.50**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “PAT POWER AUTOMATION & TEKOLGY” sh.p.k me Nr. Nipti L41723018R pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ne sistem.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ARCHISPACE & SPHAERA” sh.p.k me Nr. Nipti L42403012A / J81809003U, pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. BOE nuk disponon stafin e nevojshëm mbikëqyrës për realizimin e kësaj kontrate pasi stafi i propozuar për këtë procedurë konkretisht **Ing. Trafiku dhe sigurie rrugore (1 një), i cili duhet të jetë i pajisur me certificate “Auditues/Inspektues të sigurisë rrugore” dhe duhet të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë pune në fushën e sigurisë rrugore,* është i angazhuar në kontratë tjetër në proces ndërtimi të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar kjo në kundërshtim me pikën:

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Gjithashtu, stafi i paraqitur nga bashkimi i operatoreve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit. Bashkimi i operatoreve ekonomik në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuar përqindjen e pjesmarjes që është në raport 85 % “ARCHISPACE” dhe 15 % “SPHAERA”. Por sipas ndarjes së punimeve të përcaktuar nga vetë operatorët rezultojnë që kjo ndarje punimesh është në raport tjetër, rreth 60 % “SPHAERA” dhe rreth 40 %

“ARCHISPACE”, kjo në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, Vendimit 285, datë 19.05.2021, pika 1. “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. pika 3. “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomikë “Instituti Konsulences Ndertim “IKN”” sh.p.k me Nr. Nipti K71828007J, pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4. BOE nuk disponon stafin e nevojshëm mbikëqyrës për realizimin e kësaj kontrate pasi stafi i propozuar për këtë procedurë konkretisht **Inxhinier Mjedisi (1 një), i cili duhet të ketë mbi 5 (pesë) vite eksperiencë në punimet mjedisore.*, është i angazhuar në kontratë tjetër në proces ndërtimi të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar kjo në kundërshtim me pikën:

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Gjithashtu, menaxheri i projektit i paraqitur për këtë procedurë nuk është i profilit Infrastrukturë dhe Transport, kjo e përcaktuar qartë në DST:

-Menaxher Projekti (1 një) - Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastrukturë e Transport, me përvojë dhjetë (10) vite në projekte e zbatimin e rrugëve nga të cilat të paktën 4 (katër) vjet eksperiencë në mirëmbajtje ose në mbikëqyrje punime rrugore.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ZENIT & CO & GRAMA” sh.p.k me Nr. Nipti K61731002D / J77304712J, pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
- kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit
 - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë
- situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit (nëse ka)

Punët e paraqitura nga operatorët ekonomike nuk plotësojnë vlerën e kërkuar sipas kërkesave të mësipërme të DST.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “SWS Consulting Engineering-Structures, Water & Survey” SHPK & “INFRA - PLAN” SHPK me Nr. Nipti L92423018P / K62225011F sh.p.k pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Xhiro e paraqitur nga operatori “SWS Consulting Engineering-Structures” nuk e kap vlerën e kërkuar sipas DST.

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4 *Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), sipas kërkesave të DST:

Stafi i paraqitur nga bashkimi i operatoreve nuk është në përputhje me përqindjen e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit. Bashkimi i operatoreve ekonomik në kontratën e bashkëpunimit kanë përcaktuar përqindjen e pjesmarjes që është në raport 95 % “SWS Consulting Engineering-Structures” dhe 5 % “INFRAPLAN”. Por sipas ndarjes së punimeve të përcaktuara nga vetë operatorët rezultojnë që kjo ndarje punimesh është në raport tjetër, kjo në kundërshtim me nenin 88 “Bashkimi i Operatoreve ekonomike”, Vendimit 285, datë 19.05.2021, pika 1. “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”. pika 3. “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të

përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme **për mbikëqyrje** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në VKM Nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e mbikëqyrjes së miërmëbajtjes duhet të përmbajë kategoritë sipas kërkesave të DST:

Operatori ekonomik “SWS Consulting Engineering-Structures” disponon vetem piken NP-12, kjo ne mosperputhje me përqindjen e ndarjes se zerave te punimeve te paraqitura ne marrveshjen e bashkepunimit.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “InfraKonsult” SHPK & “Engineering Consulting Group” SHPK & “BDS Consulting Engineers” SHPK sh.p.k, me Nr. Nipti L21512022F / M01308013C / K92417018H pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit
 - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë
 - situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit (nëse ka)

Konkretisht, punët e paraqitura nga operatori ekonomik ”INFRACONSULT nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas përqindjes së paraqitur në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “S&L STUDIO” SHPK & “M.A.K Studio” SHPK, me Nr. Nipti L61606040D / L014220170 pasi nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

Xhiro e paraqitur nga operatori “ MAK STUDIO” nuk e kap vleren e kerkuar sipas DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “SEED CONSULTING” SHPK & “DERBI-E” SHPK**, me Nr. Nipti: **L41824014Q / K77916947A** me adresë: **Tirane Rruga Perlat Rexhepi, Nd.8, H.1, Ap.14**, është identifikuar si oferta e suksesshme

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme): **42,700,000.00** (dyzet e dy milion e shtatëqind mijë) **Lekë pa TVSH**

Totali i pikëve të marra: **283.50**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR**, adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë, Tel/Faks : +355 4 2234487, E-mail: info@arrsh.gov.al

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli